



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
DEPARTAMENTI I MIRADMINISTRIMIT

**RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
PËR KRYEMINISTRINË**

Periudha e raportimit : Janar – Gusht 2024

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit nr. 14, datë, 30.04.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 8-mujore për vitin 2024.

Kryeministrisë, për vitin 2024 i është akorduar fondi buxhetor, sipas programit të miratuar, konkretisht:

01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve të përgjithshme të Aparatit të Këshillit të Ministrave, dhe përmirësimin e infrastrukturës me qëllim sjelljen e tyre në parametrat e ngjashme me vendet e BE-së. Buxheti total i alokuar për Aparatin e Këshillit të Ministrave, për vitin 2024, si dhe ndryshimet pas rishikimit të tij, paraqiten si më poshtë :

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i shpenzimeve	Buxheti Fillestar i vitit 2024	Buxheti Rishikuar i vitit 2024	Plan Janar-Gusht 2024	Fakti Janar-Gusht 2024
Shpenzime Totale	789,900	810,300	583,300	436,984

Buxheti vjetor fillestar për 2024, i planifikuar për këtë program, ishte 789,900 (në 000/Lekë) dhe plani i rishikuar është 810,300 (në 000/Lekë) dhe është realizuar deri tani për periudhën Janar-Gusht 436,984 (në 000/Lekë), në shumë absolute dhe në masën 54 % ndaj planit vjetor përfundimtar. Dhe sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

Realizimi i shpenzimeve të 8- mujorit të vitit 2024 për këtë program, sipas zërave kryesorë paraqitet si më poshtë:

(Në 000/Lekë)

Emërtimi i zërave të buxhetit	Buxheti Fillestar i vitit 2024	Buxheti Rishikuar i vitit 2024	Realizimi në vlerë absolute	Realizimi në përqindje
Shpenzime paga	479,000	499,000	271,927	55%
Shpenzime dhe Sigurime Shoqërore	71,900	71,900	38,453	54%

Mallra dhe shërbime të tjera	169,000	169,000	94,542	56%
Transferta korente të huaja	40,000	40,000	32,062	80%
Transferta per buxhet Fam, dhe Indiv.	0	400,000	0	0%
Kapitale te trupëzuara (231)	30,000	30,000	0	0%
Shuma	789,900	810,300	436,984	

Në këtë program, përfshihet financimi për pagat e punonjësve të aparatit të Kryeministrit, shpenzime të cilat mbështesin rritjen e efektshmërisë së burimeve njerëzore kompetencave të tyre profesionale nëpërmjet trajnimeve, si dhe shpenzime të përgjithshme që në mënyrë periodike mbështesin monitorimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të punës, për të rritur efikasitetin e punonjësve si internet, energji, ngrohje, telefon e të tjera, për funksionimin e përbushjes së detyrave për përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe implementuese në institucion, në funksion të hartimit dhe monitorimit të politikave.

Realizimi i produkteve të parashikuara në këtë program për periudhën Janar- Gusht 2024 është si më poshtë:

Produkti: Veprimtaria e Kryeministrit për hartimin, rregullimin dhe miratimin e të gjitha akteve ligjore/nënligjore të Republikës së Shqipërisë (kodi 90301AA).

Ky produkt i parashikuar në vlerën 637,200 mijë lekë është realizuar 344,048 mijë lekë në vlerë absolute dhe e shprehur në përqindje është realizuar 54 %.

Produkti: Veprimtaria e Kryeministrit, takimeve eventeve në të cilat merr pjesë Kryeministri për të realizuar misionin e tij (kodi 90301AB).

Ky produkt i parashikuar në vlerën 103,100 mijë lekë është realizuar 60,873 mijë lekë në vlerë absolute dhe e shprehur në përqindje është realizuar 59 %.

Produkti: Republika e Shqipërisë aderon në disa organizata ndërkombëtare për të cilat është lidhur marrëveshje. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve ka detyrime për përbushjen e kontributeve financiare. Ky produkt (kodi 90301AC) zë një vlerë në buxhet prej 40,000 mijë lekë dhe është realizuar 32,062 mijë lekë në vlerë absolute dhe e shprehur në përqindje është realizuar 80 %.

Produkti: Shpenzime kapitale administrative për pajisje zyrash dhe elektronike të blera për aparatit të Kryeministrit dhe “rikonstruksione të Kryeministrit” (kodet M030025, M030029 dhe M030038).

Fondi për këto produkte është parashikuar 30,000 mijë lekë i cili pritet të përdoret në periudhën e mbetur të vitit 2024.

Referuar realizimeve sa më sipër tregon se objektivi i politikës për të patur një menaxhim sa më efektiv të buxhetit në funksion të implementimit të suksesshëm të programit konform kërkesave të kuadrit ligjor është duke u realizuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Engjell Agaçi

